



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 80, datë 24.04.2025

PËR

**“MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESEM TË KËSHILLIT TË LARTË
TË PROKURORISË PËR VITET 2026 – 2028”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me pjesëmarrjen e:

1. Zonjës Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Zotit Erind GERMENJI	Zv/Kryetar
3. Zotit Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zotit Zeqir HODA	Anëtar
5. Zonjës Arta MANDRO	Anëtar
6. Zonjës Ledina RIZA	Anëtar
7. Zotit Moisi DUDA	Anëtar (në mungesë)
8. Zotit Vatë STAKA	Anëtar (në mungesë)
9. Zotit Olger EMINAJ	Anëtar
10. Zotit Erind MERKURI	Anëtar
11. Zotit Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen e datës 24.04.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159 pika 2, germa “d” dhe 188 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, ligjin nr. 8379, datë 29.07.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, VKM-në nr. 119, datë 26.02.2025 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028”, Udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2025 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, shqyrtoi çështjen me objekt:

***“Miratimin e programit buxhetor afatmesëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitet
2026 -2028”***

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:



Pasi mori në shqyrtim, relacioni shoqërues nr. 692/3 prot., datë 23.04.2025, EMP, GMS dhe Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, dëgjoi relatorin Erion Fejzulla, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Hartimi i programit buxhetor afatmesëm të Këshilli të Lartë të Prokurorisë *(në vijim Këshilli)* për periudhën 2026-2028, është hartuar në zbatim të Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 7, datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, të Udhëzimit nr. 07, datë 28.02.2025 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2026-2028”, si dhe të VKM nr. 119, datë 26.02.2025 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028”, shkresës Nr.4073/1 datë 28.02.2025 Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit mbi “Dërgimin e udhëzimit vjetor të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026-2028”.
2. Në hartimin e programit buxhetor afatmesëm i jemi referuar kërkesave për shpenzime të politikave të reja në fushën e investimeve me qëllim final përmirësimin e veprimtarisë së prokurorisë nëpërmjet vendim marrjes së Këshillit, lidhur me miratimin e akteve nënligjore, në zbatim të ligjeve që përbejnë paketën e reformës në drejtësi, si dhe sigurimin e kapaciteteve financiare të nevojshme.
3. Kërkesat buxhetore të Këshillit, janë paraqitur sipas standardeve të miratuara, duke filluar me misionin, dhe formatin 2: Formatin standard i përgatitjes së kërkesave buxhetore PBA 2026-2028. Gjithashtu konsideratat e tjera të rëndësishme, mbi të cilat janë ndërtuar të dhënat e paraqitura në tabelat e PBA 2026-2028, janë të specifikuara më poshtë.
4. Burimi kryesor i financimit të Këshillit është buxheti i shtetit. Këshilli nuk gjeneron të ardhura të tjera.
5. Këshilli ka vijuar me kryerjen e shpenzimeve buxhetore brenda programit të vetëm buxhetor me emërtesën: “Planifikim, menaxhim dhe administrim” ku përfshihet buxheti i miratuar dhe akorduar për vitin buxhetor 2025, i ndarë sipas artikujve ekonomikë.
6. Nëpërmjet këtij programi synohet: Përmirësimi i veprimtarisë së prokurorisë nëpërmjet vendim marrjes së Këshillit, lidhur me miratimin e akteve nënligjore, në zbatim të ligjeve që përbejnë paketën e reformës në drejtësi si dhe sigurimin e kapaciteteve financiare të nevojshme, në mënyrë të shpejtë, efikase, transparente dhe me cilësi të lartë.
7. Për matjen e Performancës së programit buxhetor janë evidentuar dhe matur treguesit në



nivel qëllimi dhe treguesit në nivel objektiv, si me poshtë vijon;

a) Treguesit e performancës në nivel qëllimi

- Vendime të marra nga Këshilli;
- Pajisje TIK.

b) Treguesit e performancës në nivel objektiv

- Aktet nënligjore të miratuara nga Këshilli kundrejt vendimeve të marra;
- Magjistratë të vlerësuar kundrejt totalit të tyre;
- Numri i magjistratëve të emëruar, transferuar, kundrejt totalit të tyre.

c) Gjatë vitit 2024 plani buxhetor dhe faktik ka qenë si më poshtë:

Nr.	Zërat e shpenzimeve	Janar - Dhjetor 2024		
		Plani i Rishikuar	Fakt	Realizimi %
1	Paga	151,000	145,596	96%
2	Sigurime Shoqërore	18,600	17,027	92%
3	Mallra dhe shërbime	37,394	37,337	100%
4	Investime	10,000	0	0%
	Totali	216,994	199,960	92%

8. Nga pasqyra e mësipërme rezulton se, buxheti për periudhën janar-dhjetor 2024 është realizuar në masën **92%**, i ndarë si më poshtë:

- Paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore (600+601) realizuar **96%**.
- Shpenzimet operative (602) realizuar **100%**. Realizimi i këtij zëri vjen si rezultat i kompletimit të stafit administrativ, duke ndikuar në realizimin e procedurave të prokurimit për mallra dhe shërbime të nevojshme për mirëfunksionimin e institucionit.
- Investimet publike (231) nuk janë realizuar **0%** e fondit të planifikuar

I. KERKESAT BUXHETORE 2026-2028

9. Sa i përket kërkesave buxhetore 2026-2028, shpjegohen në tabelën sipas zërave ekonomike si më poshtë:

000/lekë

Artikujt	Buxheti	PBA 2026- 2028		
	2025	2026	2027	2028
Paga (600-601)	176,100	176,100	176,100	176,100
Korente të Tjera (602-606)	30,483	30,483	31,483	32,483
Kapitale (230-232) Të Brendshme	5,000	5,000	5,000	5,000
Kapitale (230-232) Të Huaja	0,0	0,0	0,0	0,0

Jashtë-buxhetore				
Totali	211 583	211 583	212 583	213 583



10. Sipas tavaneve buxhetore të miratuara për vitin 2026-2028, fondi për shpenzime paga dhe sigurime shoqërore (600+601) është 176,100,000 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë milion e njëqind mijë) lekë për secilin prej viteve 2026, 2027 dhe 2028.

11. Sa i përket kërkesave buxhetore për këtë vit, referuar ligjit nr. 115/2016 i ndryshuar, neni 178, germa “e” dhe “d”, i cili parashikon krijimin e njësive mbështetëse për trajnimin e prokurorëve dhe nëpunësve civilë të sistemit të prokurorisë, si edhe njësi mbështetëse për marrëdhëniet me publikun dhe botimet, theksojmë nevojën për ngritjen e një sektori të dedikuar për trajnimin dhe marrëdhënie me publikun. Aktualisht, struktura e Burimeve Njerëzore ka vetëm një specialist trajnimesh, ndërsa është e domosdoshme shtimi i një përgjegjësi trajnimesh dhe një specialisti trajnimesh shtesë. Sa i takon marrëdhënieve me publikun kemi vetëm një specialist ku edhe këtu shihet e domosdoshme shtimi i një përgjegjësi dhe një specialisti për marrëdhënie me publikun.

12. Gjithashtu, në lidhje me kalimin e dosjeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit pranë Këshillit konsiderohet e nevojshme shtimi i tre këshilltarëve në Drejtorinë e Shërbimeve Ligjore, konkretisht dy këshilltarë me profil ligjor dhe një këshilltar me profil ekonomik. Për të plotësuar këto kërkesa nevojitet një fond shtesë prej 14,500,000 (katërmëdhjetë milion e pesëqind mijë) lekë.

13. Mbi shpenzimet operative (artikulli 602)

- Sipas tavaneve buxhetore të miratuara për vitin 2026-2028, fondi për shpenzime operative është 30,483 (tridhjetë mijë e katërqind e tetëdhjetë e tre) mijë lekë për vitin 2026, 31,483 (tridhjetë e një mijë e katërqind e tetëdhjetë e tre) mijë lekë për vitin 2027 si dhe 32,483 (tridhjetë e dy mijë e katërqind e tetëdhjetë e tre) mijë lekë për vitin 2028.
- Një pjesë të mirë të shpenzimeve logjistike si roje, mirëmbajtje e zakonshme, pastrimi, gjelbërimi Këshilli i realizon nëpërmjet kontratave me Ndërmarrjen Industriale Nr.1, e cila ka në administrim godinën dhe një pjesë e konsiderueshme e buxhetit të shpenzimeve operative shkojnë për të.

14. Shpenzime Kapitale

- Fondi i shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm për periudhën 2026-2028 është në shumën e 5,000 (pesë mijë) mijë lekë për secilin prej viteve 2026, 2027 dhe 2028.
- Për vitin 2024, fondi për investime ka qenë në vlerën 10.000.000 (dhjetë milion) lekë për dixhitalizimin e akivës, i cili nuk u përdor pasi u morr vendimi që të bëhej një studim tregu në mënyrë që të bëjmë të mundur dixhitalizimin e gjithë Këshillit të Lartë të Prokurorisë me një fond të propozuar rreth 30,000,000 (tridhjetë milion) lekë.



000/lekë

	Buxheti i propozuar nga qeveria	PBA me kërkesat shtesë 2026- 2028		
Artikujt	2026	2026	2027	2028
Paga (600-601)	176,100	190,600	190,600	190,600
Korente të Tjera (602-606)	30,483	30,483	31,483	32,483
Kapitale (230-232) Të Brendshme	5,000	30,000	5,000	5,000
Kapitale (230-232) Të Huaja	0,0	0,0	0,0	0,0
Numri I punonjësve	72	79	79	79
Totali	211 583	251 083	227 083	228 083

Bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “d” të Kushtetutës, nenet 159 pika 2, germa “d” dhe 188 të ligjit Nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, ligjin Nr.8379, datë 29.07.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, ligjin Nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 119, datë 26.02.2025 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2026-2028”, Udhëzimit nr.7, datë 28.02.2025 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, dhe me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesave buxhetore në kuadër të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 për Këshillin e Lartë të Prokurorisë sipas tabelës së mëposhtme, në mijë lekë.

	Buxheti I propozuar nga qeveria	PBA 2026-2028		
Artikujt	2025	2026	2027	2028
Paga (600-601)	176,100	190,600	190,600	190,600
Korente të Tjera (602-606)	30,483	30,483	31,483	32,483
Kapitale (230-232) Brendshme	5,000	30,000	5,000	5,000
Kapitale (230032) Huaja		0,0		
Numri I punonjësve	72	79	79	79
Totali	211 583	251 083	227 083	228 083

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 24.04.2025

KRYETAR

Mirela Bogdani



KOPJE WEB